

02 SS Psalmi 1 – A do jesh i lumtur apo do humbasësh?

Hyrje – Fjala e parë e kapitullit të parë të Psalmeve është 'Lum.' Fjala e fundit e Psalmi 1 është "shkatërrim." Është sikur shkrimtari po na thotë, 'po iu tregoj për dy shtigje. Njëri sjell lumturi, tjetri do t'ju çojë në shkatërrim. Cilin shteg do të zgjidhni?'

Sa të lumtur që jemi!!

Sa të bekuar që jemi!!

Jemi të bekuar, apo jo? Kështu fillon libri i Psalmeve. Ai fillon me fjalën "lum" apo "i bekuar" dhe pastaj vazhdon të përshkruajë pse ju dhe unë si populli i Perëndisë jemi të bekuar.

Përshëndetje dëgjues të dashur dhe mirë se vini në programin tonë të sotëm ku do të shqyrtojmë psalmin e parë në serinë për këto poema të bukura të shkruara nga njerëz të Perëndisë në situata nga më të ndryshmet. Psalme të frymëzuara prej Frymës së Perëndisë dhe të përdorura nga populli i Perëndisë gjatë epokave si në adhurim publik ashtu dhe në lutje dhe meditim privat. Kjo është Kënaqësia e vërtetë e Shpirtit.

Shumë njerëz kanë komentuar sesi Psalmi 1 nuk është thjesht i pari në një varg prej 150 psalmesh që Perëndia na ka dhënë. Ky është prezantimi i gjithë librit. Psalmi 1 na tregon kushtin sesi ju dhe unë mund të përjetojmë bekim në këtë jetë dhe në përjetësi. Ai gjithashtu na tregon qartë shtegun në të cilin njerëzit humbasin.

Siç ju kam thënë ky psalm fillon me fjalën "lum" apo "i bekuar". Këtë fjalë do ta gjejmë 25 herë në librin e Psalmeve. Dje isha duke lexuar Psalmin 32 i cili fillon në këtë mënyrë, "Lum ai të cilit i kanë falur shkeljen, ai të cilit i kanë mbuluar mëkatet! Lum ai njeri të cilin Zoti nuk e padit për paudhësi dhe në frymën e të cilit nuk ka vend mashtrimi." Po ia thoja këto fjalë vetes përgjatë ditës, "Xhonatan, sa i bekuar që je. Sa i bekuar që je për shkak se të gjitha shkeljet e tua janë falur. Të gjitha mëkatet e tua janë mbuluar! Zoti nuk të padit për paudhësi. Gjithçka është harruar." Kjo ma inkurajoi zemrën në një ditë kur fare lehtë mund të kisha rënë në dekurajim. Por e refuzova këtë mundësi duke i thënë vazhdimisht vetes të vërtetën, "Jam i bekuar për shkak të veprave të hirshme të Perëndisë në jetën time."

Kështu fillon libri i psalmeve dhe në këtë mënyrë do të gjejmë kënaqësi për shpirtin tonë.

Më duket interesante që kur shkrimtari fillon Psalmin 1 ai fillon me një shembull negativ. Ai thotë, "Lum njeriu..." dhe pastaj përshkruan atë që nuk e bën njeriu i bekuar. Dëgjoni ndërsa ua lexoj vargun e parë.

Lum njeriu që nuk ecën sipas këshillës të të pabesëve,
që nuk ndalet në rrugën e mëkatarëve
dhe nuk ulet bashkë me tallësit.

Pse shkrimtari fillon në këtë mënyrë? Pse fillon duke na treguar atë që nuk duhet të bëjmë dhe si nuk duhet të jemi? Mund të them që kjo është për shkak se ai ishte i rrethuar nga njerëz të tillë – njerëz të pabesë, mëkatarë dhe tallës që e ftonin të bashkohej me ta. Presioni ishte i jashtëzakonshëm. Ata po

kënaqeshin me jetën. Gjithçka po shkonte mirë për ta, kurse jeta e shkrimtarit ishte e vështirë dhe ndjekja e Perëndisë në një botë të errët ishte sfidë e madhe.

Psalmi tregon një rrëfim besimi. Është sikur shkrimtari fillon me një deklaratë të heshtur, “Jo, unë nuk do ta ndjek atë shteg,” dhe pastaj meditimi i tij i qetë shpërthen në shpallje me zë të lartë, “Lum njeriu që NUK ecën sipas këshillës të të pabesëve, që NUK ndalet në rrugën e mëkatarëve dhe NUK ulet bashkë me tallësit.”

Ai fillon duke folur për gjëra të këqija në një mënyrë të përgjithshme kur është duke folur për të pabesët. Pastaj tregohet më specifik kur i quan mëkatarë, ata që nuk kanë qëlluar në shenjë dhe që zgjodhën shtegun e gabuar. Pastaj tregohet edhe më specifik kur i quan tallës. Tallësi është dikush që flet më përbuzje apo përçmim. Nganjëherë kur përdorim fjalën tallës nuk bëhet fjalë për dikë që me respekt nuk bie dakord. Por ky person tregon mospëlqim për ata që kërkojnë të ndjekin Perëndinë dhe ua bën këtë gjë të ditur. Në Bibël tallësi është dikush që nuk është i gatshëm të pranojë këshillë. Ai mendon se di më tepër se kushdo tjetër. Ai mendon se di më tepër se Perëndia. Perëndia i ka folur atij dhe është përpjekur ta udhëheqë në rrugën e drejtë por ai e ka larguar zemrën e tij nga udhëzimet e Perëndisë.

Dëgjoni Fjalët e Urta 13:1, “Një bir i urtë dëgjon mësimet e atit të vet, por tallësi nuk e dëgjon qortimin.” Fjalët e Urta 15:12 thotë, “Tallësi nuk e do atë që e kritikon; ai nuk shkon tek të urtët.”

A e vutë re rrëshqitjen e një personi të tillë? Ai fillon duke *ecur* sipas këshillës së të pabesëve. Rënia fillon në momentin që ai vendos të dëgjojë ata që nuk po ndjekin udhët e Perëndisë. Ai dëgjon këshillat e tyre dhe fillon t'i vërë në praktikë. Ai *ecën* në to. Pastaj ai *qëndron* në shtegun e mëkatarëve. Ai kalon në anën tjetër. Dikur ishte në shtegun e Perëndisë. Tani ai ka zgjedhur që me raste jo thjesht të dëgjojë dhe ecë sipas këshillës së të pabesëve por tani qëndron i palëkundur në atë shteg. Më në fund ai *ulet* bashkë me tallësit. Tani ai është diplomuar. Ai tani ka një post në degën e talljes të universitetit të mosbesimit. Mes tyre ai e sheh veten të ulur në një vend nderi.

Sa i lumtur është njeriu që nuk e ndjek këtë shteg! Në vend që të hedhë atë hap të parë dhe të dëgjojë këshillën e të pabesëve ai po dëgjon diçka tjetër. Ja se çfarë na thotë vargu 2, “por që gjen kënaqësinë e tij në ligjin e Zotit, dhe që mendon thellë ditë e natë mbi ligjin e tij.”

Kur lexojmë fjalën Ligj nuk duhet të mendojmë vetëm për rregullat e Moisiut të cilat i gjejmë në pesë librat e parë të Biblës. Fjala Hebraisht Torah, edhe pse disa herë përdoret në kuptimin e ngushtë për ligjet e Moisiut, përdoret gjithashtu në një mënyrë të përgjithshme për të gjitha udhëzimet e Zotit. Shkrimtari po flet për mënyrën sesi populli i Perëndisë ka nevojë të ketë zemra të hapura për udhëzimet e Perëndisë në çdo kohë dhe për çdo gjë.

Vini re që thuhet se njeriu i bekuar mediton mbi fjalën e Perëndisë. Këtu nuk po flasim për meditimin e feve të lindjes së largët. Meditimi lindor do të thotë ta zbrazësh mendjen nga gjithçka. Meditimi Biblik do të thotë ta mbushësh mendjen me fjalën e Perëndisë. Më lejoni t'ju jap një përkufizim për fjalën meditim, *të meditosh do të thotë të përfshihesh në një mendim të vazhdueshëm dhe të fokusuar.* Perëndia na ka dhënë një shembull të madh për meditimin nga bota e kafshëve – ky shembull është

lopa. Ajo e mbledh barin dhe e përtyp. Pasi e kapërcen bari shkon në stomakun e saj ku një pjesë e tij tretet por një pjesë ajo e tërheq dhe e përtyp sërish. Pastaj e çon barin e përtypur në një pjesë tjetër të stomakut ku zbutet edhe më tepër dhe një pjesë e tij përtypet sërish për 40 deri 60 herë. Pastaj bari kalon si duhet në stomak ku zbërthehet edhe më tepër. Jam i sigurt që keni parë një lopë duke u ripërtypur. Kjo është një tablo për ne për atë që duhet të bëjmë me Fjalën e Perëndisë. Ne duhet ta ripërtypim Fjalën e Perëndisë ditë e natë. Pastaj do ta kalojmë poshtë por në një moment tjetër gjatë ditës ajo fjalë duhet të kthehet sërish tek ne dhe të mendojmë më tepër për të. Ky është meditimi – të përfshihesh në një mendim të vazhdueshëm dhe të fokusuar.

Në fillim të këtij emisioni ju tregova sesi para disa ditësh po lexoja Psalmin 32:1-2 ku flitet për faljen. Herë të tjera i shkruaj vargjet e Biblës në copëza të vogla letre dhe i ngjit në muret e zyrës time. Kjo ndodhte kur kisha punë të tjera përveç punës si pastor apo mësues në këtë emision. Pjesa ime e preferuar ishte të ngjisja në murr një copë letër ku ishte shkruar Psalmi 119. Herë pas here e shihja atë copë letre dhe lexoja një varg. Në shumë raste vargjet më flisnin thellë në zemrën time dhe më ngeleshin në mendje ndërsa vazhdoja të punoja. Unë isha duke e ripërtypur fjalën! Herë të tjera kam mësuar përmendësh vargje të caktuara dhe i kam ruajtur në zemrën time. Njoh disa njerëz që shkruajnë vargje në copa letre, i mbajnë me vete dhe herë pas here i nxjerrin për t'i lexuar. Bëni çfarëdo që të jetë e dobishme për ju, por vetëm bëni diçka. Meditoni për fjalën e Perëndisë. Kjo është karakteristika kryesore e një njeriu të bekuar. Ai refuzon të dëgjojë këshillën e të pabesëve. Përkundrazi, ai e mbush mendjen e tij me fjalën e Perëndisë përgjatë ditës dhe natës.

Shikoni premtimin e Perëndisë të dhënë në vargun 3. “Ai do të jetë si një pemë e mbjellë gjatë brigjeve të ujit, që jep frytin e tij në stinën e tij dhe të cilit gjethet nuk i fishken; dhe gjithçka bën do të ketë mbarësi.” Unë jetoj në San Antonio të Teksasit dhe kufiri ndarës mes zonës kafe dhe asaj të gjelbër duket sikur kalon përmes qytetit. A e keni vënë re ndonjëherë këtë gjë në një hartë të Teksasit? Pjesa lindore është një pjesë e bukur e gjelbër dhe pjesa perëndimore është një pjesë e thatë me ngjyrë kafe. Por ky kufi kalon përmes qytetit gjë e cila do të thotë se disa vite nuk kemi mjaft shi dhe mund të ujisim vetëm një pjesë kurse vite të tjera bie më tepër shi.

Por ka një zonë të qytetit që është gjithmonë e gjelbër dhe e bukur dhe kjo është pranë lumit që kalon mes-përmes qytetit. Nëse e keni vizituar ndonjëherë qytetin tonë shpresoj që të keni pasur mundësi të ecni përgjatë shëtitorës buzë lumit. Unë dhe gruaja ime kënaqemi duke shëtitur disa herë në vit buzë lumit dhe mrekullohemi me gjelbërimin e bollshëm të bimëve. Pse ndodh kështu? Për shkak se ato pemë janë të mbjella pranë ujërave. Pavarësisht sasisë së shiut që bie gjë e cila ndikon kopshtet tona private këto pemë që gjenden përgjatë bregut të lumit marrin vazhdimisht ujin jetëdhënës, ato rriten dhe japin fryt përgjatë gjithë vitit.

Kështu mund të jemi ti dhe unë. Gjithçka varet nga fakti se ku zgjedhim ta mbjellim jetën tonë. Në vargun 1 lexojmë për një njeri që u ul bashkë me tallësit. Në vargun 3 lexojmë për njerëz që rrënjosen thellë në fjalën e Perëndisë dhe në mënyrë të vazhdueshme marrin ushqimin e saj dhe kanë mbarësi në gjithçka që bëjnë për shkak se janë të lidhur me burimin e jetës. Ata që nuk e bëjnë këtë gjë thahen dhe bëhen si byku. Shkrimtari thotë këto fjalë në vargjet 4 dhe 5, “Të tillë nuk janë të pabesët; janë si byku

që era e shpërndan. Prandaj të pabesët nuk do të përballojnë gjykimin, as mëkatarët në kuvendin e të drejtëve.”

Ju e dini çfarë është byku – janë luspat që mbështjellin kokrrat e grurit. Ato nuk kanë peshë dhe çohen tutje prej fladit më të lehtë. Ky është fundi i atyre që largohen prej udhëzimeve të Perëndisë. Ata mbeten bosh. Nuk janë më të qëndrueshëm. Nuk qëndrojnë më në këmbë. Ata i merr era drejt gjykimin ashtu si e përmyll shkrimtari psalmin me seriozitet në vargun 6, “Sepse Zoti njih rrugët të drejtëve, por rruga e të pabesëve të çon në shkatërrim.”

Lumturia dhe shkatërrimi – fjalët e para dhe të fundit të Psalmi 1. Shkrimtari na paraqet këto dy fate për njerëzit. Cilin do të zgjidhësh ti?